

Xhevati me bashkëshorten Florijen dhe pesë fëmijë jetonin në shtëpinë familjare në fshatin Gllanasellë/Gladno Selo. Në bashkësi familjare me ta ishin edhe prindërit e Xhevatit, si dhe vëllezërit e tij me familjet e tyre. Për shkak të përlëshjeve të armatosura në mes të forcave të UÇK-së dhe atyre serbe më 22.09.1998, Xhevati me familjen e tij dhe banorë të tjerë e braktisën fshatin dhe u strehuan në pyjet përmbi fshatin e **Gradicës/Gradica**. Qëndronin në një luginë. Të nesërmen [23.09.1998], Xhevati dhe disa burra të tjerë u larguan nga Florija me fëmijët. U tërhoqën më thellë në mal. Pas tërheqjes së forcave serbe nga rajoni i *Çiçavicës/Čičavica* më 25.09.1998, vëllai i Xhevatit, Bajrami, dhe disa pjesëtarë të UÇK-së e kanë zbuluar trupin e Xhevatit në një fushë afër pyllit, i cili gjendet në mes të Gradicës/Gradica dhe Zhilivodës/Zhilivode [Vushtrri/Vučitrn]. E kishte një plagë në kokë që ishte shkaktuar nga armë zjarri. E çuan në *Mëhallën Saliukaj* në Gradicë/Gradica, ku po atë ditë e varrosën. Pas përfundimit të luftës, në muajin shtator të vitit 1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Xhevatit në varrezat e Gllanasellës/Gladno Selo.

Burimi: deklarata B.B, FDH-29203.

Sefer (Rexhep) Hoti

(23.09.1948, shqiptar nga Marina, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, gjashtë fëmijë)

Rrustem (Rexhep) Hoti

(1.05.1961, shqiptar nga Marina, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë)

Enver (Sefer) Hoti

(18.06.1976, shqiptar nga Marina, komuna e Skënderajt /Srbica, nxënës)

Naim (Rexhep) Hoti

(24.11.1976, shqiptar nga Marina, komuna e Skënderajt/Srbica)

Mehmet (Azem) Saliukaj

(1976, shqiptar nga Marina, komuna e Skënderajt/Srbica, arsimtar, dy fëmijë)

Vëllezërit Seferi dhe Rrustemi dhe familjet e tyre jetonin në bashkësi. Së bashku me

ta jetonte edhe Naimi, vëllai i tyre i vogël. E gjithë familja, sikurse të gjithë banorët e Marinës/Marina [Skënderaj/Srbica], e ka braktisur fshatin më 5.06.1998. Familja Hoti u strehua te i afërmi, Azem Saliukaj, në Gradicë/Gradica. Atje qëndruan deri më **23.09.1998**, kur forcat serbe iu afruan fshatit. Kjo i detyroi të gjithë banorët e Gradices/Gradica që ta braktisnin fshatin dhe të strehoheshin në pyjet e bjeshkës së *Çiçavicës/Čičavica*. Të bindur se do të ishin më të sigurt nëse ndaheshin nga familjarët, Seferi me djalin Enverin, si dhe Rrustemi, Naimi dhe djali i Azemit, Mehmeti, u larguan nga familjarët dhe u vendosën në një bunar të braktisur, i cili ishte larg afro 150 metra nga vendi ku qëndronin gratë dhe fëmijët. Pas pak, familjarët dëgjuan të shtënat nga drejtimi i bunarit. Menjëherë pas të shtënave, pranë të zhvendosurve u paraqiten pjesëtarë të forcave serbe. I parashtruan disa pyetje për burrat dhe pastaj u larguan. Gratë pritën që forcat serbe të largoheshin nga pyjet dhe, më pas, u kthyen në fshat. Të nesërmen, dëgjuan se disa burra ishin vvarë në pyjet. Shkuan me vjehrrin e vet atje [**Gradicë/Gradica**]. Te bunari i gjetën trupat e masakruar të Seferit, Rrustemit, Enverit, Naimit dhe Mehmetit. Një ditë më vonë, më 26.09.1998, familjarët i kanë varrosur Seferin, Enverin, Naimin, Rrustemin dhe Mehmetin në varrezat e Gradicës/Gradica.

Burimi: deklarata R.H, FDH-13654.

Hamit (Sheqe) Selmani

(1912, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, bujk, shtatë fëmijë)

Hajdar (Smail) Smajli

(1920, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, bujk, gjashtë fëmijë)

Brahim (Ajet) Avdulli

(1.01.1943, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, moler, shtatë fëmijë)

Forcat policore e ushtarake serbe kanë ndërmarrë një sulm kundër UÇK-së në **Likoshan/Likošane** më 22. 09.1998.